

Vendim nr. 374, datë 02.06.2023 (i shkurtuar)

Bazuar në nenin 5 paragrafi 1.1 të ligjit nr. 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, Kodin e Procedurave Administrative, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Rregulloren e Organizimit dhe Funkcionimit të Autoritetit dhe nenit 7, paragrafi 3 të Udhëzuesit “Për rregulla dhe procedura të verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 625/10, datë 30.03.2023, Autoriteti

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së verifikimit administrativ për qëllime të qartësimit të fatit, identifikimit dhe rikuperimit të eshrave të të zhdukurve dhe të ekzekutuarve të Burgut të Spaçit. Objekti i verifikimit përfshin (a) verifikimin e dyshimeve për vendvarrime në Burgub e Spaçit (në vendvarrimet e Shpalit, Gëziqit, Kodër Spaçit (rreth 1 km në jug-perëndim të Burgut të Spaçit); (b) qartësimin e fatit të personave të vrarë apo të vdekur në vendvarrimet e dyshuara të përckatuara në pikën 1 më lart; (c) bashkëpunimin me institucionet patëse për mundësimin e identifikimit dhe rikuperimit të eshrave të personave të vrarë ose të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; (d) bashkëpunimi me institucionet për ruajtjes dhe mostjetërsimin e vendvarrimeve të identifikuar dhe dyshuara.
2. Në procedurën e verifikimit me objekt sipas pikës 1 më lart synohet të:
 - a) Të verifikohen vendvarrimet e identifikuar si të tilla të Shpalit, Gëziqit, Kodër Spacit (rreth 1 km në jug-perëndim të Burgut të Spacit);
 - b) Të koordinohet puna me autoritetet qendrore dhe vendore për pastrimin, rrethimin dhe ruajtjen e vendvarrimeve të identifikuar, para dhe pas procesit të identifikimit dhe rikuperimit të eshrave;
 - c) Analizimin dhe verifikimin e dokumenteve të administruara nga AIDSSh mbi personat në listën e Aneksit bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe atyre që mund të administrohen në të ardhmen;
 - d) Bashkëpunimi me Ministrinë e Brendshme, ICMP, Institutin e Mjekësisë Ligjore dhe me autoritete të tjera qendrore dhe vendore si dhe organizata ndërkombëtare për qëllime të bashkërendimit të veprimtarisë për identifikimin dhe rikuperimin e eshrave;
 - e) Bashkëpunimin brenda dhe jashtë vendit për realizimin e verifikimit të dyfishtë duke përdorur metoda bashkëkohore;
 - f) Identifikimi i rrethit të familjarëve dhe të afërmeve të personave të zhdukur, komunikimi dhe mmarja e dëshmimeve, të dhënave ose dokumenteve prej tyre, si dhe koordinimi me ta i veprimtarive në funksion të përkujtimit;
 - g) Vizita dhe kontrolli në vendvarrimet e identifikuar si të tilla të Shpalit, Gëziqit, Kodër Spacit (rreth 1 km në jug-perëndim të Burgut të Spacit);
 - h) Përditësimin e të dhënave mbi personat e zhdukur mbi bazën e verifikimeve të kryera, duke përfshirë por pa u kufizuar, të dhëna që hedhin dritë mbi shkaqet dhe mënyrën e vdekjes.

3. Veprimet verifikuese që do të kryhen në funksion të pikave 1 dhe 2 më lart janë:
 - a) Analizohen dokumente të administruara nga AIDSSh;
 - b) Komunikimi shkresor me institucione qendrore dhe vendore për përditësimin e të dhënave të administruara dhe qartësimin e fatit të personave të zhdukur;
 - c) Krijimi i dosjes individuale për personat e zhdukur apo të vdekur;
 - d) Identifikimi i të afërmeve të personave të zhdukur apo të vdekur.
 - e) Mbledhja e deklaratave, dëshmimeve, dokumenteve apo të dhënave të tjera, nga të afërmit e identifikuar;
 - f) Hartimi i planit të (1) vizitave dhe kontrolleve në terren, (2) komunikimeve, takimeve, marrjes së dëshmimeve nga të afërm;
 - g) Përpilimin i skicave të vendvarrimeve dhe planit të kërkimeve;
 - h) Përpilimi i raporteve individuale për secilin rast, me të dhënat dhe specifikat e rastit. Raporti individual për secilin rast duhet të përmbajë një përshkrim të veprimeve verifikuese të kryera deri më tani për rastin, të dhënave dhe dokumenteve të administruara, nevojave dhe propozimeve për veprime verifikuese të mëtejshme dhe hapave të nevojshme për t'u ndjekur me qëllim zbardhjen e rastit. Mbi bazën e përfundimeve të raportit individual për secilin rast, përpilohet një listë e veprimeve verifikuese të cilat miratohen, rast pas rasti, me urdhër të Kryetares;
 - i) Veprime verifikuese që do të çmohen të nevojshme në varësi të ecurisë së verifikimeve. Veprime të tilla identifikohen në raporte periodike dhe miratohen me Urdhër të Kryetarit.
 - j) Përpilimin a raporteve periodike mbi mbarëvajtjen dhe rezultatet e veprimtarisë sipas kësaj pike dhe raportimin e tyre përpara Autoritetit;
 - k) Përpilimin e një raporti përfundimtar me analizën e të dhënave të mbledhura.
4. Kryerja e procedurës së verifikimit kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimtarisë institucionale me institucionet dhe/ose organizata dhe/ose persona fizikë a juridikë si vijon:
 - a) Ministrinë e Brendshme dhe institucionet në varësi;
 - b) ICMP;
 - c) Institutin e Mjekësisë ligjore;
 - d) Njësitë e qeverisjes vendore të qarkut Lezhë;
5. Kryerja e procedurës së verifikimit bën të nevojshëm bashkëpunimin me ekspertë antropologë, të kriminalistikës, mjekësisë ligjore.
6. Grupi i punës përgjegjës për këtë procedurë verifikimi administrativ është:
 - a) Drejtori i DMNPIRPZH;
 - b) Specialistët e DMNPIRPZH;
 - c) Drejtori i Arkivës;
 - d) Përgjegjësi i Sekorit Juridik;
7. Veprimtaria verifikuese e grupit të punës sipas pikës 6 mbikqyret nga Anëtari i Autortietit.
8. Grupi i punës sipas pikës 6 më lart krijon, mban, ruan, përditëson dhe arkivon dosjen e procedurës së këtij verifikimi në përputhje me parashikimet e nenit 9 të Udhëzuesit “Për rregulla dhe procedura të verifikimit të rrethanave dhe fakteve mbi dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit” miratuar me Vendimin e Autoritetit nr. 625/10, datë 30.03.2023.
9. Veprimet sipas pikës 3 duhet të kryhen dhe përfundohen tërësisht brenda datës 30 tetor 2023.

10. Raportet fillestare individuale sipas pikës 3 gërma “h” hartohen brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtj vendimi. Ato përditësohen në përputhje me vijueshmërinë e veprimeve verifikuese për çdo rast.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare: Dr. Gentiana Sula

Anëtarë: Dr. Albert Nikolla, Altin Hoxha, Gjergj Marku, Skënder Vrioni